

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

SHPLLJE POZICIONI VAKANT

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës, shpall procedurën e konkurimit për vendin e lirë të punës për pozicionin:

Mirëmbajtës, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Sektori Shërbimeve Mbështetëse (Kategoria e pagës klasa VIII).

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”; VKB Nr.169 datë 24.12.2021 “Për Organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës; Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Nr.414, datë 06.01.2023 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë;

Kërkesat e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;
4. Diplomë (ose dëftesë e arsimit të mesëm) *(për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhësimi nga MAS)*;
5. Të ketë aftësi të mira drejtuese, menaxhuese, raportuese, komunikimi dhe të punës në grup;

Mirëmbajtësi ka për detyrë si më poshtë:

Mirëmbajtësi është në varësi të Përgjegjësit të Sektorit Shërbimeve Mbështetëse dhe kryen këto detyra:

1. Zbaton programin e punës sipas miratimit nga Përgjegjësi i Sektorit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
2. Mirëmban paisjet e institucionit.
3. Kujdeset për riparimin e dëmtimeve të paisjeve dhe ambienteve të institucionit, punime elektrike, hidraulike etj.
4. Raport tek përgjegjësi i sektorit për pengesat që has gjatë punës, dhe jep rekomandime përkatëse.

Dokumentat që aplikanti për Mirëmbajtës në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Sektori Shërbimeve Mbështetëse, duhet të paraqesë janë si më poshtë:

1. CV;
2. Kopje ID;
3. Diplomë (ose dëftesë e arsimit të mesëm) (*për diplomat jashtë vendit, të përcillet njehsimi nga MAS*), dhe listë notash të noterizuara;
4. Çertifikatë personale dhe familjare;
5. Librezë pune origjinale;
6. Raport mjeko – ligjor;
7. Dëshmi penaliteti;
8. 2 fotografi;
9. Çertifikata, kualifikime etj (nëse dispononi);

Dërgimi i dokumentacionit do të bëhet pranë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në adresën : Rr. “Abdi Toptani”, 1001, Tiranë, afati është deri me datë 25.09.2023 **ora** 16:30.